



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 128, datë 05.09.2012

MBI

KONTRIBUTET SHITESË TË FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2012

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 3 dhe 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, si dhe Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012, “Për krijimin, llogaritjen financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit me vendimin nr. 1, datë 18.01.2012, ka vendosur miratimin e propozimit të B.SH.S, për shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit për vitin 2012, në vlerën totale 150,000,000 lekë. Sipas pikës 3 të këtij vendimi B.SH.S brenda muajit prill 2012, duhet të depozitojë propozim për rillogaritje të Fondit të Kompensimit për vitin 2012.

Duke qenë se B.SH.S nuk depozitoi propozim për shtesë të këtij fondi, Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 74, datë 22.06.2012, vendosi plotësimin e detyrimit të Fondit të kompensimit të vitit 2012, nga shoqëritë e sigurimit “Sigal” sh.a., “Intersig” sh.a., “Atlantik” sh.a., “Albsig” sh.a. dhe “Eurosig” sh.a. brenda datës 13 korrik 2012, detyrimi i cili është plotësuar nga këto shoqëri. Gjithashtu në pikën 3, të këtij Vendimi është përcaktuar detyrimi për depozitim në Autoritet brenda datës 13 korrik 2012, të propozimit për rillogaritje të Fondit të Kompensimit shtesë për vitin 2012.

Në lidhje me zbatimin e pikës 3 të Vendimit të mësipërm, Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 4342 prot, datë 16.07.2012, informon se është në proces të inspektimit nga ana e Autoritetit dhe me përfundimin e këtij procesi së bashku me analizën e aktuarëve të shoqërive të sigurimit, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve B.SH.S, do të depozitojë propozimin për rillogaritje të Fondit të Kompensimit shtesë për vitin 2012.

Më datë 29.08.2012, B.SH.S me shkresën nr. 5439, prot., datë 28.08.2012, informon Autoritetin se në zbatim të vendimit të Bordit nr. 74, datë 22.06.2012, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në mbledhjen e radhës së datës 28 gusht 2012, miratoi në parim shtesën e Fondit të Kompensimit për vitin 2012, në vlerën 100 milion lekë, duke depozituar Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 132, datë 28.08.2012, “Për miratimin e shtesës së Fondit të

Kompensimit për vitin 2012”. Bashkëngjitur këtij vendimi janë depozituar raportet aktuariale dhe tabelat e mënyrës së llogaritjes së këtij fondi.

Sipas analizës së raportit të aktuarëve dhe tabelave për mënyrën së llogaritjes së këtij fondi rezulton se vlera e përlllogaritur del e pamjaftueshme për të mbuluar detyrimet e shoqërive të sigurimit dhe aktuarët e shoqërive duhet të rikryejnë llogaritjet duke marrë për bazë vlerat reale të numrit të mjeteve të pasiguruara, vlerën e dëmeve pezull si dhe vlerën e primit mesatar, me qëllim axhustimin e këtij fondi.

Gjithashtu referuar të dhënave të fundit të depozituar nga B.SH.S, më datë 10.08.2012, rezulton se totali i dëmeve të papaguara objekt i Fondit të Kompensimit është në vlerën **479,052,081 lekë**, dhe dëmet në proces janë në vlerën **47,503,606 lekë**.

Siç paraqitet, kontributi shtesë i Fondit të Kompensimit i propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me Vendimin nr. 132, datë 28.08.2012, “Për miratimin e shtesës së fondit të kompensimit për vitin 2012” është i pamjaftueshëm për pagesat e dëmeve sipas parashikimeve të neneve 21, 29, 30 dhe 31 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për kontribute shtesë të fondit të kompensimit, në masën 100,000,000 lekë.
2. Shoqëritë e sigurimit anëtare të B.SH.S të financojnë brenda datës 30 shtator 2012, shumën e kontributit shtesë në të njëjtin raport që zë secili anëtar në fondin e kompensimit të vitit ushtrimor.
3. Refuzimin e miratimit të tabelave për mënyrën e llogaritjes së kontributeve shtesë të fondit të kompensimit.
4. BSHS, bazuar në germën b), pika 3 të nenit 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, brenda datës 10 tetor 2012, duhet të depozitojë në Autoritet propozimin tjetër për rillogaritje fondit të kompensimit shtesë për vitin 2012, duke rishikuar tabelat e mënyrës së llogaritjes së kontributit shtesë të fondit të kompensimit.
5. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI